

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE - MINISTRY OF JUSTICE

SHERBIMI KORREKTUES I KOSOVËS - KORYKTYNA KURTA KOSOVA
KOSOVO CORRECTIVAL SERVICE

Org./Org./Org. Unit: _____
Nr./No./No. 2023 Data/Datum/Date: 04, 12, 09
Shtojca/Dodaci/Annex: _____

PRISHTINË/A



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE - MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Br.No: 01-1608
Data / Datum / Date: 01 / 12 / 2009
Shtojca / Dodaci / Annex: _____

PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice

Ministria e Drejtësisë/Shërbimi/Korrektues i Kosovës, bazuar në Ligjin mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 108 deri te neni 122, Udhëzimin Administrativ nr. 01/2007 për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës, me qëllim të përcaktimit të rregullave për sigurin në Institucione Korrektuese nxjerrë

UDHËZIM ADMINISTRATIV

**PROCEDURAT DISIPLINORE DHE MASAT PËR TË BURGOSURIT NË
INSTITUCIONET KORREKTUSE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Dispozitat e këtij udhëzimi Administrativ janë detyrues për të gjithë institucionet Korrektuese në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Çdoherë kur është e mundur, organet e Institucioneve korrektuese përdorin mekanizma ndreqje dhe ndërmjetësimi për të zgjedhur mosmarrëveshjet ndërmjet të burgosurve. Vetëm ngjarjet që kanë të ngjarë të përbëjnë kërcënim për rregullin, sigurimin dhe sigurinë mund të të përcaktohen si shkelje disiplinore. Çdo masë dhe procedurë disiplinore duhet të ruaj interesin e sigurisë dhe të një jete komunitare të rregullt dhe duhet të jetë në përputhje me ruajtjen e dinjitetit të brendshëm të të miturve /rriturve dhe objektivin themelor të kujdesetit institucional, më konkretisht një drejtësie , respekti për veti dhe respektin për të drejtat bazë për çdo person .

Neni 3

Masat disiplinore nuk duhet të përmbajn trajtim qnjerzor apo degradues , duke përfshir ndëshkimin fizik, vendosjen në një qeli të errtë ,apo ndonjë mdëshkim që mund të komprimiotoj shëndetin fizik apo mendor .

Neni 4

Me këtë Udhëzim administrativ përcaktohen :

- Sjelljet që përbëjnë shkelje disiplinore
- Llojin dhe kohëzgjatjen e masave disiplinore që mund të merren
- Autoritetin kompetent për marrjen e masave të tilla
- Autoritetin kompetent për të shqyrtuar ankesat

SJELLJET QË PËRBËJN SHKELJE DISIPLINORE DHE PROCEDURA

Neni 5

Zgjidhja jo formale: Zgjidhja e shkeljes disiplinore në atë mënyrë që nuk kërkon përdorimin formal të procesit disiplinore. Zgjidhja joformale nënkupton pranimin vullnetar të masave të propozuara për zgjidhjen e sjelljes së papranueshme, nga ana e të burgosurit.

Neni 6

Kontrabandë: Sende të veçanta të paautorizuara që do të kishin ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë dhe sigurimin e burgut, personelit, të burgosurve dhe publikut. Kjo përfshinë:

- a. Pije alkoolike dehëse dhe substancat narkotike
- b. Të gjitha armët ose komponent nga kjo, municion për armë, dhe çdo gjë që është e dizajnuar për të vrarë, lënduar ose gjymtuar një person ose në diçka që mund të vras, lëndoj ose gjymtoj një person, kur përdoret pa autorizim paraprak;
- c. Eksploziv, bombe ose komponentë prej kësaj;
- d. Të gjitha mjetet komunikuese ,telefon mobil, SIM kartele, radio ose mjete tjera komunikuese
- e. Para (monedhe) mbi çdo kufi të shkruar të aplikuar kur posedohet pa autorizim paraprak, dhe
- f. Çdo send që nuk është përshkruar në paragrafët (a) deri në (e),e të cilat mund të rrezikojnë sigurinë e burgut ose sigurinë e personave, kur ky send posedohet pa autorizim.

Neni 7

Sendet e paautorizuara: çdo send tjetër që është i paautorizuar nga Praktikant Standarde të Veprimit ose nga urdhri me shkrim i Drejtorit të burgut dhe që i burgosuri e posedon pa autorizim paraprak.

AUTORITETIN KOMPETENT PËR MARRJEN E MASAVE TË TILLA DISIPLINORE

Neni 8

- a. Vetëm personeli i burgut ka kompetenca disiplinore mbi të burgosurit.
- b. Vetëm gjykata kompetente dhe anëtarët e personelit të institucioneve korrektuese (bazuar në shkresat e gjykatës), kanë kompetenca mbi të paraburgosurit.

PËRGJEGJËSITË E DREJTORIT TË BURGUT

Neni 9

9.1 Drejtori i Burgut duhet të sigurojë që disiplina e të burgosurit:

- a. Synon të inkurajojë sjellje të pranueshme dhe ta korrigjojë sjelljen e papranueshme;
- b. Nxite zgjedhjen joformale për shkeljet disiplinore të të burgosurit;
- c. Merr parasysh gjendjen shëndetësore të të burgosurit si dhe nevojat fizike dhe psikike të kujdesit mjekësor, dhe
- d. Nxite përgjegjësinë personale dhe dhënien e llogarisë

9.2 Drejtorët e burgjeve duhet të sigurojnë se të burgosurit informohen me gojë dhe me shkrim për rendin shtëpiak në institucion, duhet të informohen se mosrespektimi i rregullave mund të shpie në marrjen e masave disiplinore.

LLOJET DHE KOHËZGJATJA E MASAVE DISIPLINORE QË MUND TË MERREN

Neni 10

10.1 I burgosuri kryen shkelje të lehte disiplinore kur:

- a. Nuk i bindet urdhrit të justifikueshëm të anëtarit të personelit;
- b. Gjendet pa autorizim në vendin e ndaluar për të burgosur;
- c. Tregohet i parespektueshëm apo abuziv ndaj anëtarit të personelit;
- d. Tregohet i parespektueshëm apo abuziv ndaj ndonjë personi duke e provokuar atë person për të qene i dhunshëm;
- e. Refuzon të punoj ose e le punën ose nuk paraqitet në punë për arsye të papranueshme;

- f. Merret me bixhoz;
- g. Me dashje nuk i bindet urdhrit të shkruar që përcakton sjellje e te burgosurve.
- h. Përpiqet ta beje ose ndihmon ndonjë person tjetër në kryerjen e secilës vepër që përmendet nga paragrafi (a) deri në (g).

10.2. I burgosuri kryen shkelje të rënde disiplinore kur:

- a. Rrahët, sulmon ose kërcënon të sulmoj personin tjetër;
- b. Dëmton apo shkatërron pronën që nuk ehte e vetja ma dashje apo me pakujdesi;
- c. Kryen Vjedhje;
- d. Posedon prone të vjedhur;
- e. Ofron, jep apo prano rryshfet ose shpërblim;
- f. Është në posedim ose merret me sendin e palejuar;
- g. Konsumon pa autorizim barna të rrezikshme narkotike, substanca narkotike ose alkool;
- h. Krijon ose merr pjesë në trazira ose në ndonjë aktivitet tjetër i cili ka gjasa të rrezikoj sigurinë e burgut;
- i. Përgatite ndonjë aksion me qëllim që të arratiset, ose
- j. Lëshon burgun ose nuk kthehet në burg pa autorizim.
- k. Malltregon dhe ka dëshmi për abuzime seksuale ndaj të tjerëve

ZGJIDHJA E SHKELJEVE DISIPLINORE

Neni 11

- a. Në rast se anëtari i stafit ka arsye për të besuar se i burgosuri ka, ose është duke kryer shkelje disiplinore, atëherë anëtari i stafit duhet se pari ta zgjidhe çështjen në mënyrë joformale.
- b. Zgjidhja joformale nuk do të zbatohet të kundërvajtet serioze
- c. I burgosuri duhet të njoftohet në kohën e shkeljes ose në kohën kur shkelja bëhet e qarte se do të përgatitet raporti i incidentit dhe kundër tij/saj po ngritët akuza, me përjashtim të rastit vetëm kur ekzistojnë arsye të veçanta për të mos vepruar në mënyrë të tillë.

Neni 12

Anëtari i personelit duhet të përgatisë raportin mbi shkeljen, me shkrim, që duhet të përmbajë këto elemente:

- a. Datën dhe kohën e shkeljes;
- b. Emrin e te burgosurit(ve) të përfshirë;
- c. Emrat e te gjithë dëshmitarëve duke përfshirë edhe te burgosurit tjerë;
- d. Përshkrimi i shkeljes dhe i rrethanave që e rendojnë atë, dhe
- e. Akuza që do të ngritët.

Neni 13

Për secilin te burgosur te përfshire ne një incident duhet te plotësohet një raport për te cilin do te ngritët akuza.

Neni 14

Duhet te plotësohet nja raport për secilën shkelje qe përshinë secilin te burgosur veç e veç.

Neni 15

Kur te përfundohet raporti i shkeljes duhet t'i dorëzohet zëvendës drejtorit përgjegjës për rishqyrtim dhe hetime te mëtejshme nëse është e nevojshme. Pas shqyrtimit te akuzës zëvendës drejtori duhet e sqaroj nëse akuza është e lehte apo e rende.

Neni 16

Te burgosurit duhet ti jepet një njoftim mbi dyshimi (akuzën) dhe masën disiplinore që do i shqiptohet, brenda 20 orëve te klasifikimit te saj dhe do te përmbajë minimum informatat e poshtëshënuara:

- a. Subjektin e akuzës;
- b. Datën, kohen dhe vendin e shkeljes se dyshuar disiplinore;
- c. Te prezantohen përmbledhje te dëshmimeve për te mbështetur akuzën, dhe
- d. Datën , kohen dhe vendin e dëgjimit.

Neni 17

Para dëgjimit i burgosuri mund te dorëzoj listën e dëshmitareve dhe /ose dokumenteve qe ai/ajo, dëshirojnë te merren ne konsiderate gjate dëgjimit.

Neni 18

Kur i burgosuri te jete ndare nga te burgosurit tjerë si rezultat i sjelljes qe ka quar ne ngritjen e akuzës disiplinore, dëgjimi i atij te burgosuri do te ketë prioritet mbi çdo dëgjim tjetër te shkeljeve disiplinore.

Neni 19

Normalisht akuza mund te tërhiqet vetëm nga ngritësi i saj.

Numri i akuzave

Neni 20

I burgosuri nuk duhet te ndëshkohet dy here për te njëjtën akuzë.

Neni 21

Nëse i burgosuri, me një apo me shume vepra ka kryer disa shkelje disiplinore për te cilat ne te njëjtën kohë janë bere procedurat disiplinore, ndëshkimi disiplinor për secilën shkelje disiplinore se pari duhet te përcaktohet dhe mandej te behet një ndëshkim disiplinore i përgjithshëm për te gjitha shkeljet disiplinore dhe me këtë rast do vie në shprehje parimi i aspiracionit .

Seancat Dëgjimore

Neni 22

Drejtori dhe zv.drejtori i burgut do te jete përgjegjës për t'i kryer dëgjimet disiplinore për te gjitha akuzat e renda dhe merr vendim mbi ato.

Neni 23

Udhëheqësi dhe Mbikëqyrësi i Larte përgjegjës do te jete përgjegjës për t'i kryer dëgjimet disiplinore për te gjitha akuzat e lehta dhe te merr vendim mbi to.

Neni 24

I burgosuri i cili vendosë qe te mos ndjek dëgjimin duhet t'i kërkohet qe heqjen dore nga kjo e drejte ta paraqesë me shkrim. Nëse i burgosuri refuzon qe ta paraqes kërkesën me shkrim, atëherë oficeri duhet ta përpilon raportin me shkrim dhe të nënshkruhet nga tre oficer prezent për këtë rastë dhe ta nënshkruajn për këtë qellim. I burgosuri i cili heq dorë nga e drejta e pjesëmarrjes ne dëgjim duhet te informohet se seanca do te vazhdoj ne mungesë e tij/saj.

Neni 25

I burgosuri mund te zgjedhe ta revokoj dorëheqjen e tij/saj ne çdo kohë para dëgjimit dhe këtë mund ta bëjë duke informuar Drejtorin e burgut ose zëvendës drejtorin përgjegjës.

Neni 26

I burgosuri i cili është akuzuar duhet t'i jepet mundësi te arsyeshme gjate dëgjimit :

- a. T'i ftoj dhe beje pyetje dëshmitareve përmes drejtueseve te dëgjimit, te paraqes dëshmi, te kontrolloj provat materiale dhe dokumentet qe konsiderohen ne marrjen e vendimit, dhe
- b. Te paraqesë parashtresa gjate dëgjimit duke përfshirë ato qe zbatohen me sanksionet përkatëse.

Neni 27

I burgosuri i cili nuk e kupton siç duhet gjuhen gjate dëgjimit ka te drejte për ndihmese të përkthyesit.

Neni 28

Nëse gjate dëgjimit te shkeljes se rende Drejtori i Burgut vendos qe akuza duhet te zvogëlohet ne shkelje te lehte(kundërvajtje), ai ndryshon akuzën dhe vazhdon dëgjimin.

Neni 29

I burgosuri nuk duhet shpallet fajtorë përderisa personi i cili e dëgjon rastin është i kënaqur me dyshimin e arsyeshëm, duke u bazuar me dëshmitë e prezantuara ne dëgjim, se shkelja disiplinore e kryer nga i burgosuri është ne pyetje.

Neni 30

Për te burgosurin i cili refuzon te paraqesë mbrojtje dëgjimi duhet te zhvillohet sikurse nuk është i shpallur fajtorë.

Neni 31

I burgosuri mund te mbaje shënime gjate procedurës.

Neni 32

Para se te shqiptohet masa mbi te burgosurin e shpallur fajtorë për shkeljen, ai/ajo duhet pyetur nëse kane diçka për te thënë.

Neni 33

I burgosuri duhet te njoftohet me gojë për rezultatin e dëgjimit disiplinorë nga personi i cili e ka mbajtur atë para mbylljes se seancës dëgjimore.

Neni 34

Te dhënat e secilit dëgjim duhet te mbahen dhe te ruhen për se paku dy (2) vite pas lirimit të burgosurit.

Neni 35

Secili burg duhet të mbajë Regjistër të Vendimeve. Ky regjistër duhet të përmbajë informatat vijuese:

- a. Datën e dëgjimit
- b. Emrin e të burgosurit
- c. Natyrën e Akuzës
- d. Mbrojtjen (deklaratën)
- e. Zbulimin dhe
- f. Masën e shqiptuar Dëshmia

Neni 36

Drejtuesi i dëgjimit disiplinorë mund të marrë në pyetje ndonjë dëshmitarë gjatë dëgjimit.

MASAT PËR SHKELJET DISIPLINORE.

Neni 37

Masat disiplinorë duhet të jete në pajtueshmëri me shkeljen disiplinore të kryer nga i burgosuri.

Neni 38

Nuk duhet të merret vendim i joformal për raste kur të ketë ndodhur një shkelje e rënde disiplinore.

Neni 39

Para shqiptimit të masës drejtuesi i dëgjimit duhet të marrë parasysh:

- a. Përmasat e shkeljes dhe shkallen e përgjegjësisë që i burgosuri mban për atë shkelje;
- b. Masën më të vogël kufizues që do të ishte i përshtatshëm në ato rrethana;
- c. Të gjitha rrethanat përkatëse renduese dhe lehtësuese, duke përfshirë sjelljen e të burgosuri dhe përmbushjen e punës në burg;
- d. Masën e shqiptuar ndaj të burgosurve tjerë për shkelje të ngjashme (krahasimet)
- e. Natyrën dhe kohëzgjatjen e çdo mase dhe çdo mase tjetër të fundit të shqiptuar ndaj të burgosurit për të siguruar se kombinimi i masave disiplinore nuk është i tepërt;
- f. Çdo mase veçimi nga të burgosurit e tjerë që ehte marrë në lidhje me shkeljen në zbulimin të dënimit dhe

Neni 40

I burgosuri i cili është shpallur fajtorë për shkelje të lehte disiplinore mund të marr një ose më shumë nga këto masa që vijojnë:

- a) Qortim
- b) Humbje e një privilegji për maksimum shtatë (7) ditë, dhe
- c) Dëmshpërblim në vlerë jo më të madhe se 15 €. Kjo mund të tërhiqet nga kantina e të burgosurit për një periudhë kohore.

Neni 41

I burgosuri i cili është shpallur fajtorë për shkelje të rëndë disiplinore, mund të marrë një ose më shumë nga këto masa që vijojnë:

- a. Humbje e një privilegji të caktuar për maksimum 15 ditë
- b. Dëmshpërblim në vlerë jo më të madhe se 25 €, Kjo mund të tërhiqet nga kantina e të burgosurit për një periudhë kohore.
- c. Vetmi jo më shumë se 15 ditë për secilin shkelje disiplinore.

Neni 42

Të miturit nuk mund të jenë subjekt të vetmisë si ndëshkim disiplinorë.

Neni 43

Masa mbi humbjen e privilegjeve duhet të përcaktoj kufizimet e saktë që zbatohen mbi bazën e individit.

Neni 44

Masa mbi dëmshpërblimin ose gjobën duhet të shqiptohet pas shqyrtimit të gjendjes financiare të të burgosurit.

Mbyllja në vetmi

Neni 45

Para se të urdhërohet për ndëshkim me vetmi, Drejtori i burgut duhet të marr me shkrim mendimin e mjekut i cili dëshmon se i burgosuri është në gjendje të shëndetshme fizike dhe psikike.

Neni 46

Kur për të burgosurin vendoset vuajtja e një periudhe të ndëshkimit me mbyllje në vetmi si subjekt i një dënimi të mëparshëm të mbylljes në vetmi, duhet të specifikohet nëse të dy periudhat duhet të mbahen njëra pas tjetrës apo njëkohësisht.

Neni 47

Nëse masa ndarjes mbahen njëra pas tjetrës, koha e përgjithshme e ndarjes që i shqiptohet nga masa nuk duhet ti kaloj 30 ditë.

Neni 48

Kur që të dy masat e mbylljes në vetmi kanë për qëllim të përfshijnë humbjen e privilegjeve të tjera, privilegjet e humbura duhet të përcaktohen si pjesë e sanksionit të plotë të shkeljes.

Neni 49

I burgosuri nuk duhet të vendoset në vetmi për një periudhë kohore prej më shumë se dy (2) muaj gjatë një viti kalendarik.

Neni 50

Nëse gjatë kohës së mbylljes në vetmi mjeku është i mendim, it se vazhdimi i mbylljes do të kërcënonte shëndetin e të burgosurit, kjo duhet të ndërpritet.

Neni 51

Qelia e vetmisë duhet të ketë tualet, lavaman, drite të mjaftueshme, shtrat, mbulesa të shtratit, tavolinë karrige dhe nxehje.

Neni 52

Të burgosurit në vetmi kanë të drejtë për:

- a. Të njëjtat kushte higjienike dhe shëndetësore sikur të burgosurit tjerë;
- b. Një orë shëtitje në ajër të pastër;
- c. Një vizitë të mbyllur nga bashkëshorti/ja ose anëtarë tjerë të familjes, në periudhë prej 15 ditëve, dhe
- d. Qasje në libra dhe shkrime.

Neni 53

I burgosuri në vetmi duhet të vizitohet nga zyrtari mjekësorë për çdo ditë dhe nga Drejtori, zv drejtori burgut dhe zyrtari social një herë në shtatë (7) ditë.

Qëndrimi me Kusht i Ekzekutimit të Ndëshkimit Disiplinorë

Neni 54

Ekzekutimi i masës disiplinorë mund të jete i qëndrimit me kusht për një periudhë të gjashtë (6) muajve për çdo sanksion përveç qortimit.

Neni 55

Qëndrimi me kusht i ndëshkimit disiplinorë duhet të revokohet nëse gjatë periudhës së qëndrimit në ekzekutim është ngritur një ndëshkim i ri disiplinorë, përveç qortimit ndaj të burgosurit.

Neni 56

Kur të jetë revokuar qëndrimi me kusht i ekzekutimit, duhet të ngritet një ndëshkim i përbashkët për shkeljen disiplinore të mëparshme dhe shkeljen e re, Ndëshkimi i mëparshëm disiplinorë duhet të trajtohet si i prerë dhe ndëshkimi i përbashkët disiplinorë duhet të ngritet duke aplikuar rregullat e llogaritjes së ndëshkimeve disiplinore për shkeljet e përbashkëta.

Neni 57

Kur të jetë revokuar qëndrimi i kushtëzuar i ekzekutimit të shkeljes disiplinore të mbylljes në vetmi, vetmia e shqiptuar nuk duhet të kalojë njëzet (20) ditë nëse humbja e privilegjeve të caktuara është shqiptuar për shkelje të mëvonshme, por nëse mbyllja në vetmi është shqiptuar për shkelje të mëvonshme, mbyllja në vetmi me tridhjetë (30) ditë maksimum mund të shqiptohet.

Lajmërimi

Neni 58

I burgosuri duhet sa më shpejtë që të jetë e mundur të informohet me shkrim mbi vendimin e seancës dëgjimore.

KUJDES I POSAQËM DO TË KET AUTORITETI PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

-AUTORITETIN KOMPETENT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

Neni 57

I burgosuri mund të fillojë procedurën e ankesës pas marrjes së vendimit për çdo ndëshkim disiplinorë. Ankesa duhet të bëhet brenda 3 ditëve pas pranimit të vendimit. Ankesa nuk parandalon ekzekutimin në vendimit.

Neni 58

Nëse Drejtori i burgut apo zëvendës drejtori pajtohet të ndryshojë apo shfuqizojë vendimin, i burgosuri duhet të pranohet përgjigjen brenda 72 orëve prej kur është pranuar nga drejtori i burgut ose mbikëqyrësi i lartë.

Neni 59

Nëse drejtori i burgut ose zëvendës drejtori nuk ka vepruar ashtu si ka kërkuar i burgosuri, apo nuk e shfuqizon vendimin, ai ka të drejt ta përcjell ankesën tek Komisionari brenda një periudhe të mëtejme prej 24 orëve.

Neni 60

Komisionari duhet të vendosë për ankesën brenda 3 ditëve të pranimit të saj. Vendimi do të kthehet prapa të Drejtorit të burgut i cili pastaj duhet ta dorëzojë atë të i burgosuri.

Neni 60

Ky Udhëzim administrativ hynë në ditën e nënshkrimit të tij

Prishtinë:25.11.2009

Ministria e Drejtësisë
Nekibe Kelmendi
Nekibe Kelmendi
Ministre

